



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 616/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Elhami Dobra dhe Arbnon Gashi, komisioner nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur më 08.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e pas afatshme ankesa e Elhami Dobra dhe Arbnon Gashi, komisioner nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK),
Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.11.2013, nga Elhami Dobra dhe Arbnon Gashi, komisioner nga subjekti politik PDK, në të cilën pretendohet se në QV 1924e/01R Shkolla Filllore “Meto Bajraktari” është bërë gabim i plotësisimit të formularit përfundimtar nga kryesuesja lidhur me rezultatin e votave të subjektit politik PDK.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pas afatshme

PZAP-i, konstatoi se ankesa e Elhami Dobra dhe Arbnon Gashi, është e pas afatshme sepse ankesa nuk është bërë në afatin e paraparë ligjor 24 orë nga shkelja e supozuar deri më 04.11.2013 ora 19:00, por e njëjta është dorëzuar më 05.11.2013 në ora 11:25.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3.2 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pas afatshme

, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa

A nr. 616/2013 më datën 08.11.2013



**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.